



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.Shk II.nr.1605/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovë (RBKO), me seli në Prishtinë, rr. "Robert Doll", nr.99, kundër debitorëve 1. A.H.M., B.I me numër unik identifikues 810083593 me seli Malishevë, rr. "Adem Jashari", 2. A,M, me adresë në Astrazup, Malishevë, dhe 3. H.M. me adresë në Astrazup, Malishevë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve 1. A.H.M. dhe 2. H.M., të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.797/22 të datës 25.09.2023, me datë **01.03.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorëve: 1.A.H.M. dhe 2.H.M., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.797/22 të datës 25.09.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.797/22 të datës 25.09.2023, ne dispozitiv të aktvendimit ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit A.H.M. B.I i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1313/2021 datës 08.09.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë debitorët A.H.M. dhe H.M., (*me pretendime sikur në ankesë*) duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anuloj vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.797/22 të datës 25.09.2023 dhe të bie vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë. Mbi arsyet e lartcekura ka kërkuar nga gjykata të vendos si në propozimin e lartpërmendur.

Kreditori ka ushtruar përgjigje ne ankesë nëpërmjet së cilës ka theksuar se dokumentet të cilat i ka bashkangjitur kreditori paraqesin titull ekzekutiv në kuptim të nenit 22 të LPP-së, përkatësisht neni 1 par.9 të LPP-së dhe Ligjit nr.05/L-118 e në kuptim të nenit 5 par 1.7, pasi që

në rastin konkret kemi të bëjmë me peng dhe sipas ligjit në fuqi dokumenti i tillë e përmbush kushtin e titullit ekzekutiv pasi që krijimi i pengut është regjistruar në regjistrin e pengut pranë ARBK-së, pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me numër të konfirmimit R-20190613.

- Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Raiffeisen Bank Kosovë (RBKO), me seli në Prishtinë ka lëshuar Urdhrin përmbarimor P.nr.1313/2021 datës 08.09.2021, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të Marrëveshjes mbi kolateralin (pengun e luajtshëm) e datës 10.06.2019, e regjistruar sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20190613 e datës 13.06.2019, marrëveshje kjo për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja mbi Kredinë nr.200720494 e datës 10.06.2019 të lidhur mes kreditorit dhe debitorëve, me qëllim të realizimit të borxhit të papaguar të kredisë nga debitori në vlerë prej 27,427.96 EUR, si dhe kamata e rregullt dhe kamatëvonesa që do të arrijë deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore të gjitha këto në afat prej 7 ditësh.

Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha me seli në Prizren, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me urdhrin përmbarimor P.nr.1313/2021 datës 08.09.2021, e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke e kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarimor me arsyetimin se debitori ka shkuar disa herë te kreditori për ta ri dizajnuar kredinë për një kohë më të gjatë dhe këst më të ultë por një gjë të tillë nuk e ka pranuar analisti i kredisë-kreditori. Tutje ka shtuar se është dashur që propozimit për përmbarim t'ia bashkëngjesh provat faktike në mënyrë që të jetë një pasqyrë më e qartë e borxhit real andaj, ka kërkuar nga gjykata që të refuzoj propozimin për përmbarim që është parashtruar nga kreditori ndërsa prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit me arsyetimin se debitori nuk ka respektuar marrëveshjet e nënshkruara nga ana e palës debitore duke u vonuar në përmbushjen e detyrimit pasi që kredia është marrë në vitin 2019 në shumën prej 30.000.00€ ndërsa deri në vitin 2021 borxhi i mbetur i kredisë figuron në shumën prej 27,552.59€. Ka shtuar se debitorit i është refuzuar ristrukturimi i kredisë sepse e njëjta kërkesë nuk ka qenë në përputhshmëri me procedurat e brendshme të bankës meqë debitori është vonuar në kredinë aktuale, biznesi ka qenë i mbyllur, kredi marrësi nuk ka pasur të ardhura personale. Andaj nga të lartcekura gjykatës i ka propozuar që Prapësimi të refuzohet dhe Urdhri Përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë

aktvendimin KPPP.nr.797/22 të datës 25.09.2023, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit A.H.M. B.I i ushtruar kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.1313/2021 datës 08.09.2021, të lejuar nga Përmbarruesi Privat Rushit Hoxha.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se Marrëveshja mbi kolateralin (pengun e luajtshëm) e datës 10.06.2019, është e regjistruar në regjistrat publik të pengut, kjo sipas konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20190613 e datës 13.06.2019 dhe po ashtu është paraqitur në kopje të vërtetuar nga origjinali dhe si e tillë përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 par.1.7 a dhe neni 27 të LPP-së, për të qenë të përmbarrueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përmbarrim

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të neni 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbarrimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarrimin sipas dokumentit të përmbarrimit, parashihen sipas dispozitës së neni 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, nr.05/L-118 të, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore ku në mesin e dokumenteve përmbarrimore në bazë të cilave organi përmbarrues mund të caktoj përmbarrimin është edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.

Dhoma e Shkalles se Dytë, vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor i debitorit se aktvendimi i atakuar është marrë me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për faktin se në rastin konkret përmbarruesi privat e ka lejuar përmbarrimin duke u bazuar të Marrëveshjes mbi kolateralin (pengun e luajtshëm) e datës 10.06.2019, e regjistruar sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20190613 e datës 13.06.2019, dhe te njëjtat paraqesin dokumente përmbarruese në kuptim të dispozitës së neni 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, me të cilën parashihet se “1. *Dokumente përmbarruese janë 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit*” ndërsa me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore me nenin 5 përcaktohet si në vijim” 2. *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit*

*1.7.,shtohet nën-paragrafi i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.*

Gjykata e shkallës së dytë ka analizuar edhe pretendimet tjera të debitorit por të njëjta mbasin vetëm në natyrën deklarative dhe të pambështetura në prova konkrete siç parasheh dispozita 69 par.4 të LPP dhe si të tilla nuk janë relevante për vendosje ndryshe prandaj kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi të refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetojë.

Përndryshe, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II nr.1605/23 me datë 01.03.2024**

**Gjyqtari,**  
Faton Bajrami